



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr 1035 Prot

Tiranë, më 24.02 2020

URDHËR

Nr. 105, Datë 24 / 02 /2020

**PËR MARRJEN E MASAVE HIGJENO-SANITARE PËR PARANDALIMIN E  
PËRHAPJES SË INFEKSIONEVE RESPIRATORE AKUTE PËRFSHIRË DHE COVID-  
19 NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE, KOPSHTE DHE ÇERDHE DHE  
INSTITUCIONE TË TJERA ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15/2016, datë 10.03. 2016 “Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive” ,

**URDHËROJ:**

1. Operatori Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor në bashkëpunim me strukturat e varësisë të bashkërendojnë punën me strukturat e institucioneve parashkollore, institucionet e tjera arsimore dhe strukturat përgjegjëse për kopshtet dhe çerdhet në njësitë e qeverisjes vendore, për marrjen e masave të mëposhtme:
  - a. Sigurimin e kushteve dhe artikujve higjeno-sanitare në mjediset e institucioneve parashkollore dhe institucionet e tjera arsimore, duke përdorur solucionet pastruese dhe dezinfektuese përkatëse.
  - b. Sigurimin e higjenës personale për të gjithë fëmijët, nxënësit dhe studentët, që frekuentojnë këto institucione, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik bashkëlidhur këtij urdhëri.

- c. Sigurimin e higjenës personale për personelin arsimor dhe mbështetës, që shërben në këto institucione.
  - d. Edukimin e vazhduar të fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në lidhje me masat e higjenës personale, sipas rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Personeli shëndetësor në institucionet parashkollore dhe ato arsimore të kërkojë nga drejtuesit e institucionit arsimor, të paraqesin numrin total të mungesave në frekuentim për arsye shëndetësore.
  3. Ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik, institucionet parashkollore, institucionet e tjera arsimore dhe strukturat përgjegjëse për kopshtet dhe çerdhet në njësitë e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**  
**Ogerta Manastirliu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

**Udhëzues për pastrimin e mjedisit në objektet (jo te kujdesit shëndetësor) te ekspozuar ndaj virusit 2019-nCoV**

Ky udhëzues synon të sigurojë rekomandime në lidhje me pastrimin e mjedisit në objektet jo-shëndetësore (p.sh. dhoma, zyra publike, transporti, shkolla, etj.), ku ka patur raste të konfirmuara me koronavirus i ri (2019-nCoV) përpara se të shtrohen në spital. Ky udhëzues bazohet në njohuritë aktuale për 2019-nCoV dhe provat që burojnë nga studimet mbi koronaviruset e tjerë.

**COVID-19**

Agjenti shkaktar i përfshirë në shpërthimet e tanishme të sëmundjes akute të frymëmarrjes të SARS-CoV-2, (gjini: Betacoronavirus), i përket familjes së Coronaviridae, një familje e madhe e ARN viruseve. Koronaviruset transmetohen në shumicën e rasteve përmes sperklave të mëdha të frymëmarrjes dhe transmetimit direkt të kontaktit, por gjithashtu janë menduar edhe mënyra të tjera të transmetimit.

Koha e mbijetesës dhe kushtet që ndikojnë në qëndrueshmërinë e virusit 2019-nCoV në mjedis nuk dihen me saktësi. Sipas studimeve që vlerësojnë qëndrueshmërinë mjedisore të koronavirusëve të tjerë, koronavirusi i Sindromës së Rëndë Akute të respiratore (SARS-CoV) mbijeton disa ditë në mjedis dhe koronavirusi i lidhur me sindromën respiratore të Lindjes së Mesme (MERS-CoV) më shumë se 48 orë në një temperaturë mesatare e dhomës (20 ° C) në sipërfaqe të ndryshme [1-3].

**Menyrat e pastrimit të mjedisit**

Për shkak të mbijetesës së mundshme të virusit në mjedis për disa ditë, ambientet dhe zonat e kontaminuara potencialisht me 2019-nCoV duhet të pastrohen para ripërdorimit të tyre, duke përdorur produkte që përmbajnë agjentë antimikrobikë të njohur si efektiv kundër koronavirusëve. Edhe pse ka mungesë të provave specifike për efektivitetin e tyre kundër virusit 2019-nCoV, pastrimi me ujë dhe pastruesit shtëpiak dhe përdorimi i produkteve të zakonshëm dezinfektues duhet të jenë të mjaftueshme për pastrimin e pare të përgjithshëm. Disa agjentë antimikrobikë janë testuar kundër koronavirusëve të ndryshëm (Tabela 1). Disa nga përbërësit aktivë, p.sh. hipokloriti i natriumit (që përmbahet në zbardhimin shtëpiak) dhe etanol janë gjerësisht të disponueshme në mjediset jo-shëndetësore dhe jo-laboratorike.

Një studim i kohëve të fundit i cili ka krahasuar lëndë të ndryshme germicide që përdoren në ambiente të kujdesit shëndetësor [4], zbuloi se ato lëndë me përqendrim 70% etanol kishin një efekt më të fortë në dy koronaviruset të ndryshme pas një kohe kontakti një minutë në sipërfaqe të forta kur krahasohet me 0.06% hipoklorit i natriumit. Testet e kryera duke përdorur SARS-CoV treguan se hipokloriti i natriumit është efektiv në një përqendrim prej 0,05 dhe 0,1% pas pesë minutash, kur përzihet në një solucion që përmban SARS-CoV [5]. Rezultate të ngjashme u morën duke përdorur pastrues shtëpiak që përmbajnë sulfat lauril të eterit, alkil poliglikozid dhe acid dietanolamide [5].

**Tabela 1.** *Agjentet antimikrobike efektive kundër Koronaviruseve të ndryshëm*

Agjenti antimikrobial	Përqendrimi	Koronaviruset e testuar	Referenca
Etanol	70%	HCoV-229E, MHV-2, MHV-N, CCV, TGEV	(4,6,7)
Hipoklorit Natriumi	0.1-0.5%, 0.05-0.1%	HCoV-229E, SARS-CoV	6
Povidone-Jodine	10% (1% Jodine)	HCoV-229E	5
Glutaraldehyde	2%	HCoV-229E	6
Izopropanol	50%	MHV-2, MHV-N, CCV	6
Klorid benzalkonium	0.05%	MHV-2, MHV-N, CCV	7
Klorit Natriumi	0.23%	MHV-2, MHV-N, CCV	7
Formaladehide	0.70%	MHV-2, MHV-N, CCV	7

### Qasjet e pastrimit

Përdorimi i hipokloritit të natriumit 0.1% (hollimi 1:50 nëse përdoret zbardhues shtëpiak në një përqendrim fillestar prej 5%) pas pastrimit me një pastrues neutral sugjerohet për qëllime të dekontaminimit, megjithëse nuk ka të dhëna për efektivitetin ndaj SARS-CoV-2.

Për sipërfaqet që mund të dëmtohen nga hipokloriti i natriumit, përqendrimi 70% i etanolit është i nevojshëm për dekontaminim pas pastrimit me një pastrues neutral.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

**UDHËZUES MBI MËNYRËN E LARJES SË DUARVE**

**MËNYRA E KRYERJES SË HIGJENËS SË DUARVE**

Përdorni dezinfektantin e duarve për një higjienë më të mirë!  
Lani duart kur janë të ndotura në mënyrë të dukshme!

Kohëzgjatja e procedurës zgjat 20-30 sekonda.

1. Hidhni solucionin dezinfektant në pëllëmbën e dorës dhe përhapeni atë në të gjithë sipërfaqen, figura 1a dhe 1b.
2. Fërkoni pëllëmbët e duarve me njëra-tjetrën.
3. Kaloni pëllëmbën e njëres dorë mbi kurrizin e dorës tjetër, kryqëzoni gishtat me njëri-tjetrin dhe ripërsëriteni procesin në të kundërt.
4. Fërkoni pjesët palmare të të dyja duarve dhe kryqëzoni serish gishtat.
5. Kapni duart me njëra-tjetrën nëpërmjet gishtave të kundërt me njëri-tjetrin.
6. Fërkoni me njëren dorë gishtin e madh të dorës tjetër duke e fërkuar në mënyrë rrethore, dhe përsëriteni veprimin në dorën tjetër.
7. Fërkoni në mënyrë rrethore me gishtat e njëres dorë pjesën palmare të dorës tjetër, dhe përsëriteni të njëjtin veprim me dorën tjetër.
8. Kur duart janë të thara, ato janë të sigurta.


**KUR DUHET TË PËRDORET LARJA ME SAPUN E DUARVE?**

**LANI DUART KUR ATO JANË NË MËNYRË TË DUKSHME TË NDOTURA-  
NË TË KUNDËRT PËRDORNI DEZINFEKTANTIN E DUARVE!**


Teknikat e larjes së duarve me ujë dhe sapun




Lagen duart me ujë.



Aplikohet mjaftueshëm sapun.




Fërkohen mirë të dyja duart.




Me dorën e djathtë të vendosur në pjesën dorsale të dorës së majtë, fërkohen hapësirat mes gishtave.




Kalohet në sipërfaqen palmare, sërisht me gishtat e kryqëzuar.




Pjesa e pasme e gishtave fërkohet me pjesën pëllëmbës të dorës tjetër.



Fërkohet gishti i madh i dorës duke rrotulluar pëllëmbën e dorës tjetër. Po kështu edhe për gishtin tjetër.




Fërkohet pjesa palmare e njëorës dorë dhe me gishtat e dorës tjetër që bëjnë lëvizje rrethore dhe para-pas.



Shpëlahen duart me ujë



Thahen mirë me peshqir që përdoret vetëm një herë.



Përdoret peshqiri për të mbyllur rubinetin.



Dhe duart tuaja janë të sigurta.